



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 23.12.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 117/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesës për ri-shqyrtim të datës 21.12.2020, të parashtruar nga Grupi i OE "MARISA SHPK DHE COMPANY MURSELI" lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "**Ndërtimi i parkingjeve dhe stacioneve të autobusëve**", me Nr. të Prok: **632-20-7006-5-1-1**, nxjerr:

### V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Grupi i OE Ekonomik të "**MARISA SHPK DHE COMPANY MURSELI**" e dates 14.12.2020, lidhur me aktivitetin e "**Ndërtimi i parkingjeve dhe stacioneve të autobusëve**", me Nr. të Prok: **632-20-7006-5-1-1**, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 17.12.2020, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.
- 2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të publikuar me datë **17.12.2020**;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

## Arsyetim

Grupi i OE Ekonomik **MARISA SHPK DHE COMPANY MURSELI** me datë 14.12.2020, ka parashtruar Kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **"Ndërtimi i parkingjeve dhe stacioneve të autobusëve"**, me Nr. të Prok: **632-20-7006-5-1-1**,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 23.12.2020, ka shqyrtuar Kërkesën në fjalë si më poshtë:

1. Në lidhje me pretendimin ankimor nr. 1 se është bërë shkelje e nenit 1, AK sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar referencën sic e kërkon LPP andaj kjo pikë e ankesës është e pabazuar.
2. Në lidhje me pretendimin ankimor se OE ankues nuk e ka veprimtarinë e ndërtimit AK sqaron se kërkesë e FDT ka qenë "Regjistrimi si Operator Ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit" dhe si dëshmi "Certifikata e regjistrimit të biznesit (kopje)" dhe se nuk është kërkuar veprimtaria andaj kjo pikë e ankesës është e pabazuar.
3. Në lidhje me pretendimin ankimor se OE ankues se mungon referenca dhe kontrata, AK sqaron se përpos listës së kontratave OE i rekomanduar për dhënie ka ofruar referencën si dëshmi sic është kërkuar tek FDT si në vijim "Lista e kontratave të realizuara së paku një në 3 (tri) vitet e fundit, duke saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve- furnizim dhe vendosje të kabinave të ngjashme" dhe se kontrata nuk është kërkuar farë tek dëshmitë në FDT.
4. Në lidhje me pretendimin ankimor se OE ankues ka ofruar të gjitha kriteret e njoftimit për kontratë me cmimin më të ulët e se më këtë ka bërë shkelje të nenit 1, AK sqaron se nuk ka bërë shkelje të këtij neni sepse ka rekomanduar për dhënie të kontratës OE të përgjegjshëm me cmimin më të ulët dhe se oferta e OE ankues ka qenë e papërgjegjshme sipas arsyeve të dhëna në letrën standarde për tenderues të eliminuar.
5. Po ashtu, OE ankues ka ofertuar vetem me "MARISA SHPK" ndërsa në ofertë janë bashkëngjitur edhe dokumente të "COMPANY MURSELI" andaj në bazë të kësaj nuk mund të merren për bazë dokumentet e ofruara në ofertën tuaj.  
Përpos kësaj, OE ankues nuk ka ofruar certifikatat "ISO 9001 2015" dhe "ISO 14001 2015" të kërkuara tek FDT.

Tenderi juaj nuk është i suksesshëm për arsye se cmimi juaj nuk është më i ulëti në mesin e tenderëve që plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve nga publikimi i Vendimit në platformën elektronike <https://e-prokurimi.rks-gov.net/>**

Kopje: Grupi i OEt Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;  
Arkivit të Komunës

Faton Gutaj  
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

